

Prot 1643/1

dt. 20.12.2019

**Marrëveshje Bashkëpunimi për krijimin e “Aleancës kundër urrejtjes”**

Sot, në datën 20.12.2019, në Tiranë,

**Avokati i Popullit**, përfaqësuar nga Avokatja e Popullit, zonja Erinda BALLANCA;

**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, përfaqësuar nga Komisioneri, zoti Robert GAJDA;

**Autoriteti i Mediave Audiovizive**, përfaqësuar nga Nënkryetari, zoti Sami NEZA;

**Shoqata “Këshilli Shqiptar i Medias”**, përfaqësuar nga Kryetari, zoti Koloreto CUKALI;

**V E N D O S I N:**

**Neni 1**

Krijimin e “Aleancës kundër urrejtjes”.

**Neni 2**

“Aleanca kundër urrejtjes” ka për objekt të veprimtarisë së saj:

- a) Ngritjen e vetëdijes, informimin dhe kontribuimin në dialogun, veçanërisht midis të rinjve, për luftën ndaj gjuhën e urrejtjes, dhe krijimin e urave të dialogut dhe bashkëveprimit me shoqërinë civile dhe organet publike, mbi pasojat e gjuhës së urrejtjes në shoqërinë shqiptare, ndikimin e saj në zhvillimin demokratik të vendit dhe reduktimin e këtij fenomeni në shoqërinë shqiptare.
- b) Të promovojë lirinë e shprehjes në shoqërinë demokracike duke lehtësuar një debat të hapur dhe sensibilizues për publikun për promovimin e lajmit në mënyrë korrekte dhe të drejtë. Për realizimin e këtij objekti kryen përpjekje për të vendosur një dialog të qëndrueshëm me komunitetin e tanishëm dhe të ardhshëm të mediave. Asnjë grup ose individ nuk mund të përjashtohet si rezultat i gjuhës së urrejtjes dhe “Aleanca kundër urrejtjes” do të bëjë përpjekje për promovimin e diversitetit në media dhe kontribuimin për një nivel të vazhdueshëm të “konsumit” të lajmeve në respektim të të drejtave të njeriut në Shqipëri.
- ç) Sigurimi i një harmonizimi më të plotë ndërmjet legjislacionit civil dhe atij penal kundër diskriminimit. Nxitjen e publikimi të rregullt dhe të saktë të statistikave për gjuhën e urrejtjes sipas Kodit Penal.

d) Intensifikimin e përpjekjeve për të mundësuar që të gjithë organet publike në Shqipëri të jenë të ndjeshëm dhe të adresojnë çështjen e gjuhës së urrejtjes.

dh) Sensibilizimin dhe intensifikimin e përpjekjeve për të parandaluar përdorimin e gjuhës e urrejtjes në internet dhe/ose në mediat sociale, si dhe mënyrat e luftimit të tyre.

e) Rritja e aftësisë së mësuesve dhe aftësive profesionale të mësuesve, si dhe forcimi i përpjekjeve në mjedisin arsimor të të gjitha niveleve ndaj fenomeneve negative të gjuhës së urrejtjes dhe parandalimit të saj.

ë) Kryerjen e studimeve dhe dhënien e rekomandimeve, kryesisht ose në bashkëpunim me aktorë të tjerë vendas apo ndërkombëtarë, për të zbuluar ndikimin që ka gjuha e urrejtjes te individit dhe grupet sociale sidomos ato më të prekshme të ekspozuar ndaj saj dhe rekomandime mbi marrjen e masave legjislative dhe/ose ekzekutive për eliminimin e këtij fenomeni në shoqërinë shqiptare.

f) Rritja e ndërgjegjësimit të punëdhënësve dhe punëmarrësve, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, për detyrimin për të parandaluar dhe adresuar gjuhën e urrejtjes, krimet e urrejtjes dhe ngacmimit në vendin e punës, si dhe garantimin e përpjekjeve sistematike për luftimin e saj në fushën e shëndetit, sigurisë dhe mjedisit në vendin e punës.

### **Neni 3**

1. “Aleanca kundër urrejtjes” do të drejtohet me rotacion për çdo periudhë kohore gjashtë mujore, sipas rendit alfabetik të emërtesës së institucionit.

2. Detyrat e sekretarisë teknike të “Aleancës kundër urrejtjes” i kryen institucioni që ka radhën e drejtimit sipas rotacionit. Institucioni i radhës ka asistencën e zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë në kuadrin e projekteve të përbashkëta me Bashkimin Evropian “Mekanizmi horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022”.

3. “Aleanca kundër urrejtjes” ka logon e saj, e cila vendoset në faqet e internetit të secilës prej nënshkruesve të kësaj Aleance.

### **Neni 4**

Të gjitha vendimet që mund të marrë “Aleanca kundër urrejtjes” duhet të miratohen me konsensus mes të gjithë anëtarëve të saj.

### **Neni 5**

1. “Aleanca kundër urrejtjes” e zhvillon veprimtarinë e saj në Mbledhje Plenare dhe në takimet e punës.

2. Mbledhja Plenare zhvillohet të paktën dy herë në vit dhe i kushtohet një fushe apo teme të veçantë brenda objektit të veprimtarisë së Aleancës.

3. Takimet e punës së “Aleancës kundër urrejtjes” zhvillohen sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Aleancës. Rregullorja e Organizimit dhe funksionimin miratohet në mbledhjen e parë të konstituimit të “Aleancës kundër urrejtjes”.

### Neni 6

1. Kjo Marrëveshje i shtrin efektet juridike për një afat kohor të pacaktuar.
2. Marrëveshja mund të ndryshohet me shkrim në çdo kohë, me miratim të përbashkët të Palëve.
3. Marrëveshja nënshkruhet në 4 kopje origjinale dhe depozitohet nga një kopje pranë institucionit të secilës prej Palëve nënshkruese.

Tiranë, më 20.12.2019

**NËNSHKRUESIT**

**Avokati i Popullit**

**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

**Autoriteti i Mediave Audiovizive**

**Këshilli Shqiptar i Medias**

The image shows several handwritten signatures in blue ink over two official circular stamps. The stamps are from the Republic of Albania, with the text 'REPUBLIKA E SHQIPERISE' and 'TIRANE' visible. One stamp also includes 'KOMISIONERI PER MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI' and 'TIRANE'. The signatures are written over the stamps and extend across the page.

